

**KONTRATE PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGTARE
(AKT-THEMELIMI)
"DARDANIA-BESIANA" SHPK .**

Ne mbështetje te legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit 9723 dt.03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit", i përditësuar , unë personi juridik .

DRITON ZHJEQI, I biri i **SHEMSIUT** dhe i **MAGBULES** i datëlindjes 01.01.1965, lindur ne Podujevë, Kosovë dhe banues ne Podujevë , Kosovë, Rr. "Hasan Prishtina", Nr. 30 , Podujevë – Kosovë i identifikuar me karte identiteti me Nr. Personal : 1015840583 dhe ID:0384305, madhor , me zotësi te plote juridike për te vepruar, sipas aktit themelues dhe statutit ka vendosur formimin e shoqërisë tregtare me ortakët si me poshtë vijon.

**Neni 1
FORMIMI I SHOQËRISË**

Formohet Shoqëria Tregtare me përgjegjësi te kufizuar me emërtimin "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK ,me ortakë themelues si me lartë dhe administrator **Z. DRITON ZHJEQI**, me e-mail: **daradania.shpk1@gmail.com** dhe kontakt telefonik **00 386 4 973 0499** .

**Neni 2
SELIA**

Selia e Shoqërisë Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK, është ne Tiranë ne adresën: **Lagja: Rr. "Shyqyri Bërxolli dhe Besim Mema", Nr. 103** .

**Neni 3
KOHËZGJATJA**

Shoqëria Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK ka një kohëzgjatje te veprimtarisë se saj ekonomike te pakufizuar.

**Neni 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarisë ekonomike i Shoqërisë Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" **SHPK** do të jete si me poshtë vijon:

1. Eksport-Import , tregtim me shumicë dhe pakicë **karburante, gaz dhe të gjitha llojet e lëndëve djegëse.**
2. Veprimtari **komisionarë, ndërmjetësimi, përfaqësimi, konsulence për kompanitë e huaja dhe vendase .**
3. Eksport-Import , tregtim me shumicë dhe pakicë materiale, ndërtimi, produkteve e industrial, veshmbathje, ushqimore, industriale, bujqësore dhe blegtorale.
4. Eksport-Import , tregtim me shumicë dhe pakicë makina për transporte , për udhëtim , tokësor dhe detar, makina bujqësore, makina përpunuese të produkteve ushqimore bujqësore dhe blegtorale , veshmbathje të të gjitha llojeve duke përfshirë edhe rroba dhe pajisje pune.
5. Eksport-Import , tregtim me shumicë dhe pakicë për të gjitha llojet e drurit si dhe përpunimin e tije si mobilieri, apo produkte ngrohje peleta , e tjera.
6. Eksport Import , blerje shitje mbeturina të riciklueshme,të të gjitha llojeve , duke përfshirë edhe mbeturinat spitalore të cilat do të përdoren për djegje (prodhim energji nga nxehtësia) , për qëllime industriale e tjera .
7. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin në fushën e ndërtimeve të ndryshme për strehim, ndërtimeve hotelerie, qendra turistike, objekti civile e tjera .
8. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin edhe në fusha të tjera si më poshtë :
 - a. Studimi, projektimi, financimi, ndërtimi, menaxhimi i ndërtime civile, ekonomike, social-kulturore dhe industriale, ushtarake, tregtare, shtëpi banimi, infrastrukture, rruge, ura, kanalizime dhe ujësjellës, parqe industriale, aeroport ale etj.
 - b. Investime ne turizëm, ndërtim , hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, bar-kafe, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi dhe kurative ne fushën e turizmit ne përgjithësi.
 - c. Agjenci dhe aktivitet imobiliar , shitje blerje te pasurive te paluajtshme si dhe te pasurive te luajtshme.
 - d. Aktivitet ne fushën e transportit te mallrave dhe pasagjerëve me mjetet e vete shoqërisë ose për llogari të të tretëve, hapje te agjencive turistike.
 - e. Hyrja ne marrëveshje dhe biznese me shoqëri te tjera qe kane te njëjtin objekt veprimtarie.
 - f. Krijimi, blerja, financimi, investimi, hyrja ne marrëdhënie te ndryshme me te tretet, kryerja e sipërmarrjeve dhe projekteve, ofrimi i shërbime dhe asistencës se te gjitha llojeve, personave fizike dhe juridike, përfshi shërbimet menaxhuese, këshilluese, planifikuese, financiare, turistike, teknike, administrative.
 - g. Kryerja e shërbimeve për vete dhe për te trete, rikonstruksione për vete dhe te trete, prodhimi i materialeve te ndërtimit dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice.
 - h. Kërkimi, analizimi dhe përzgjedhja e personelit tekniko-administrativ. Punësimi i personelit te kualifikuar dhe vënia ne dispozicion te kompanive ndërkombëtare. Konsulence juridike me kontraktor e huaj ne trajtimin e ligjeve shqiptare apo çështje te ndryshme ligjore. Konsulence me



- kontraktorët e huaj ne kërkimin e personelit lokal tekniko-administrativ dhe vënia ne dispozicionin te kontraktoreve. Konsulence me kontraktore te huaj dhe vendas për tenderimin e projekteve me financim te huaj.
- i. Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme për arritjen e objektit te saj, duke përfshirë edhe pjesëmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqëri dhe ndërmarrje te tjera.

Neni 5

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT .

Shoqëria ka një ortak të vetëm **z. DRITON ZHJEQI** .

Ortaku ka këto te drejta kryesore:

- Te administroje aktivitetin e shoqërisë ne përputhje me Statutin dhe Aktin Themelues;
- Te marri pjese ne fitimet e çfarëdo forme e sasi te aktivitetit te Shoqërisë, te parashikuara nga Akti themelues e Statuti i Shoqërisë.
- Te marri ne çdo moment dokumente, si raporti i administrimit, inventarë e llogari vjetore, për tre vitet e fundit financiar.
- Te tërhiqet nga Shoqëria, duke ia ofruar kuotën e vet me përparësi te tjerëve. Ne mungese te ushtrimit te se drejtës se parablerjes nga ana e ortakeve te tjerë, kuota mund t'iu kaloje te tretëve, sipas kushteve e afateve ne parashikuara ne nenin 7 te Aktit Themelues dhe ne nenin 9 te këtij Statuti.
- Të emëroj përfaqësues ligjor, administrator këshilltar vendas dhe të huaj dhe të gjithë personelin që i nevojitet për mbarëvajtjen e punëve të shoqërisë, sipas Ligjeve të Shtetit Shqiptar dhe të huaj .

Neni 6

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK është 100.000 leke (njëqindmijë leke), i investuar dhe i shlyer tërësisht nga kapitali i ortakut themelues **z. DRITON ZHJEQI**, referuar Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 e vijim "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" .

Neni 7

Ky kapital është investuar nga ortakut i vetëm, vlera nominale e te cilave është 1.000 (njëmijë) leke. Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar nënshkruhen ne tërësinë e tyre dhe shlyhen tërësisht nga ortakët themelues referuar Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 8

Ne raste se gjate rrugës kërkojnë futen ortak te tjerë, ortakut i vetëm ka të drejtë të shesë tërësisht po pjesërisht kuota të shoqërisë duke shtuar nëmurin e ortakëve sipas Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Në rast se mbas momentit të shtimit të ortakëve dikush nga ortakët kërkon te tërhiqet nga Shoqëria apo qe kërkon t'iu shesë te tretëve, pjesërisht ose tërësisht,



kuotat e tij duhet t'ia komunikojë vendimin e vet me shkrim Asamblesë së ortakëve. Ai duhet t'ua ofrojë përparësisht kuotën e vet ortakëve të tjerë. E drejta e parablerjes duhet ushtruar brenda afateve të përcaktuara sipas Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ne rast mos ushtrimi të së drejtës së parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë, kuota mund t'u jepet të tretëve me një çmim jo me të vogël nga ai i ofruar ortakëve. Ne rastin kur blerja behet nga të trete ortakët që shet duhet t'u komunikojë ortakëve të tjerë emrin e blerësit si dhe kushtet e shitjes sipas Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 9

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të Shoqërisë Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK, janë Asambleja e Shoqërisë dhe Administratori i saj sipas Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Asambleja e Shoqërisë Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK drejtohet nga Administratori i saj i cili emërohet nga ortakët i vetëm. **Administratori i do të jetë ortakët DRITON ZHJEQI, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.**

Në rastin e futjes së ortakëve të tjera, administratori emërohet me vendim asambleje .

Me vendim asambleje këtë kushtë (rotacionin) mund ta ndryshojnë duke ndërruar vendet e marrjes së administratorit, sipas Ligjit.

Emërimet dhe ndryshimet e administratorëve behet me vendim të ortakut të vetëm në rastin konkret dhe me vendim asambleje, në momentin e shtimit të nëmurit të ortakëve gjatë rrugës, njoftimi behet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si dhe në drejtorin rajonale të tatimeve .

Fusha e veprimit, përbërja dhe funksionimi i organeve drejtuese, emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve dhe çështje të tjera të këtyre organeve rregullohen sipas Statutit të Shoqërisë, që është pjesë përbërëse e këtij Akti, si dhe me dokumente të tjera të brendshme të Shoqërisë që do të miratojë Asambleja e saj sipas Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"..

Neni 10

Shoqëria Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK, ka zgjedhur si **Administratori i do të jetë ortakët DRITON ZHJEQI, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.**

Administratori ka të gjitha fuqitë për administrimin e zakonshëm e të jashtëzakonshëm dhe për përfaqësimin tek të tretet si dhe në gjykim sipas Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"..

Neni 11



Shoqëria Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK zhvillon aktivitetin e saj sipas dispozitave normative urdhëruese të Ligjit 9901 dt. 14/04/2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 12

Shoqëria ka vulën e saj zyrtare me përmbajtje:
Shoqëria Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK.

Neni 13 **MARRREDHENIET E PUNES**

Marrëdhëniet e punës në Shoqërinë Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK rregullohen sipas dispozitave të Statutit të saj.

Neni 14 **BILANCI DHE TË ARDHURAT**

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Në mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqërisë bën inventarin dhe llogarite vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton një raport me shkrim për administrimin.

Raporti i administrimit, inventarët dhe llogarite vjetore të hartuara nga Administratori, i nënshtrohen miratimit të Asamblesë së ortakut të vetëm apo ortakëve të tjerë në rast të shtimit të tyre gjatë rrugës, brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 15

Të ardhurat neto pas shlyerjes së detyrimeve fiskale dhe atyre ndaj të tretëve, kalojnë në llogarinë e ortakut të vetëm ose ndahen midis ortakëve të Shoqërisë në rastin e shtimit të tyre gjatë rrugës, në përputhje me kuotat e secilit në formimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 16 **PRISHJA E SHOQERISE**

Shpërbërja e Shoqërisë Tregtare "**DARDANIA-BESIANA**" SHPK mund të vije në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak, duke vepruar sipas kritereve të parashikuara në nenin 31 të Statutit të Shoqërisë.

Neni 17 **DISPOZITA TË PERGJITHSHME**

Të gjitha kundërshtimet eventuale midis ortakëve të Shoqërisë zgjidhen nga Gjykata e Rrethit të Tiranës, ose me ndërmjetësim në përputhje me Ligjin 10385



24/02/2011. Por kundërshtimet mund të zgjidhen edhe nga një gjykatë brenda apo jashtë Shqipërisë, në rast se ortaket kanë rënë dakord midis tyre.

Neni 18

Ky statut përpilohet në pesë kopje për:

- Qendrën Kombëtare të Regjistrimit
- Zyrën e Tatimit - Taksave për marrjen e lejes së ushtrimit të veprimtarisë
- Dhomën e Notarisë
- një kopje mbetet si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë tregtare **"DARDANIA-BESIANA" SHPK.**

- Një kopje i ngelet hartuesit të këtij akti, zyrës së avokatisë .

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "DARDANIA-BESIANA" SHPK .

DRITON ZHJEQI

Dr. Driton Zhjeqi



Përgatiti AKT TEHEMELIMIN

Avokat & Ndërmjetës

Dr. Gjergji HABILAJ


